

PROTESTA



**PRESIDENTI META:
"ULEM NË GJUNJË
PARA POPULLIT. KJO
PRANVERË KUQEZI NUK
NDALET MË"**

Faqe 4

PROFILI



**ONEDA SKËNDERI:
"NDAL" ATYRE
QË SHKELIN TË
DREJTAT TONA DHE
KUSHTETUTËN**

Faqe 6

REAGIMI



**BASHA NË TUBIMIN
E METËS: LIRIA
RRËNOHET KUR
KUSHTETUTA SHKELET!**

Faqe 7

Demokratët e Bulqizës përkujtojnë 29 vjetorin e themelimit të Degës së Partisë Demokratike

ISAKU: PAS REFORMËS ZGJEDHORE, ZGJEDHJE TË PARAKOHËSHME

Ne kemi një mision historik

DEFRIM FIKU

29 vjet më parë, në kushtet e terrorit policor dhe përgjimit të Sigurimit të Shtetit, një grup intelektualësh, njerëzish të thjeshtë, por me intuitën dhe vlerat e mëdha prej demokratësh, krijuan Partinë Demokratike, në Bulqizë, partinë e parë opozitare të vendit, pas territ komunist 45 vjeçar. Për këtë ngjarje madhore të qytetit më të rëndësishëm të ekonomisë së vendit, por dhe popullit të tij, falenderimi ynë gjithmonë do të shkojë për z. Bashkim Lami dhe njerëzit që u bënë bashkë, të cilët kuptuan mjaft mirë atë që i duhej vendit, të ardhmes së Shqipërisë dhe Bulqizës. Bulqiza ka qenë dhe mbetet qyteti më industrial i Shqipërisë, çfarë nënkuptonte dhe prezencën më të madhe të veglave të diktaturës, por grupi demokrat e përballoi këtë vështirësi, dhe para 29 vitesh, solli dallëndyshen e parë të lirisë dhe dinjitetit njerëzor. Gjatë 29 viteve, Shqipëria është përballur me sfidat e rëndësishme për të bërë prezente dhe vepruese lirinë njerëzore, aq e vlerë dhe e përdhunuar gjatë rregjimit totalitar, si dhe sot, sfidën për ta bërë jetike ekonominë e tregut, si burimi i konkurrencës dhe zhvillimit; për krijimin e institucioneve të demokracisë, pa të cilët demokracia nuk do të ishte funksionale; për projektin madhor të zhvillimit ekonomik dhe social, i cili prek çdo individ, familje, çdo fshat, njësi administrative dhe rrethin; për krijimin e një projekti afatgjatë të rritjes së mirëqenies së çdo familjeje, dhe në rrethin tonë.

Vijon në faqen 3



• I pranishëm në këtë aktivitet festiv ishte edhe Nënkryetari i Partisë Demokratike të Shqipërisë, Edmond Spaho, i cili në fjalën e tij vlerësoi punën e kësaj dege. Spaho tha se miratimi i reformës zgjedhore do të çojë vendin në zgjedhje të parakohshme

LIBRI

Disa gra të shquara nga Bulqiza në librin me 805 faqe të poetit e publicistit Kujtim Boriçi



"Oficeret shqiptare në rrjedhën e historisë", publicistikë me vlera, dokumentare e historike

ENGJËLL MUSAI - DREJTOR I GAZETËS "TELEGRAF"

Faqe 11

FJALA

Faqe 7

Të gjithë së bashku për Kushtetutën, për të ardhmen...



PROF. BUJAR KAPEXHIU - NDERI I KOMBIT

REPORTAZH

Faqe 8

Vlerësim heronjve të nëntokës së Bulqizës




ABDURAHIM ASHIKU

PARATHËNIA

Faqe 10


**POEZIA E ZEQR
HYSËS BURON NGA
DAMARËT E TOKËS
MIMOZA ÇOBO***



PROFILI

Faqe 11

Oficerja e re, Klenisa Xheka nga Bulqiza: "Uniforma më bëri të përjetoj emocione të veçanta"



Kryetari i opozitës e ka konsideruar qeverinë jo vetëm të papërgatitur për përballjen me coronavirusin, por edhe të papërgjegjshme

pandemia

Basha denoncon skandalin: Qeveria e papërgjegjshme, ndau 1.2 milionë maska të skaduara që në vitin 2011

Gjatë një konference për shtyp kryetari i PD-së Lulzim Basha tregoi para shqiptarëve se si qeveria ka shpërndarë 1.2 milionë maska të skaduara që në vitin 2011. Skandali kriminal i qeverisë shkon edhe më tej kur kutive të këtyre maskave u kishte mbulluar datën e skadencës dhe mbi to kishte vendosur një datë tjetër.

Ai i bëri thirrje Prokurorisë të veprojë menjëherë. Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, iu bëri thirrje të gjithë qytetarëve të mos panikohen nga përhapja e koronavirusit, pasi sipas tij, nuk është koha për panik, por për kujdes.

Kryetari i opozitës, Basha e ka konsideruar qeverinë jo vetëm të papërgatitur për të përballur përballjen me coronavirusin, por edhe të papërgjegjshme.

Basha sulmoi ashpër qeverinë, pasi sipas tij, personeli shëndetësor po punon me maska të skadu-



ara, duke rrezikuar jo vetëm jetën e tyre, por duke u bërë edhe burim i përhapjes së virusit te qytetarët.

“Nuk është koha për panik, por është koha për kujdes. Kjo është një thirrje për të rritur kujdesin. Nëse

vihemi në panik nuk do të mund të kujdesemi as për veten tonë, as për familjarët tanë dhe kryesisht për të moshuarit, që kanë më shumë nevojë.

Është shumë e rëndësishme që të ndiqen me përpikëri këshillat e mjekëve, duke shmangur sa të jetë e mundur grumbullimet. Mburoja e vetme kundër këtij virusi janë shërbimet shëndetësore. Dua të ndaj një shqetësim të jashtëzakonshëm.

Personeli shëndetësor rrezikon me maska të skaduara. Ata kthehen në viktimat e para dhe transmetues të virusit te qytetarët. Kjo është papërgjegjshmëri totale.

Spitalet janë totalisht të papërgatitura për fluksin, e kam fjalën për ata që do kenë nevojë për trajtim në kushte spitalore. Kapacitetet aktuale nuk kalojnë 120 njësi të përgatitura për të trajtuar 120 të infektuar, që ju kërcënohet jeta. Kjo është kronikë e një dështimi”, tha Basha.

KORONAVIRUSI, SHTOHEN MASAT NË DOGANËN E BLLATËS



Zyrtarizimi i rasteve të para me koronavirus ka bërë që në pikat doganore të vendit tonë të intensifikohen kontrollat e personave që hyjnë, nëse janë bartës të virusit Kovid19. Edhe në doganën e Ballatës janë rritur kontrollat ku ato bëhet njëherësh për disa persona që hyjnë nga shteti fqinj i Maqedonisë së Veriut. Drejtori i Njësisë Vendore të Shërbimit Shëndetësor Dibër, Hasan Manja tha se tashmë puna e grupeve të mjekëve të dislokuar aty është më intensive pas shfaqjes së rasteve tashmë edhe në vendin tonë. Ai shtoi se kontrollove tani ju nënshtrohen të gjithë personat që hyjnë, ndryshe nga më parë që kontrolloheshin vetëm të huajt. Manja tha se deri tani nuk ka patur asnjë rast të dyshimtë të të prekurve me koronavirus ndërsa janë hapur karantina në doganën e Bllatës dhe në Dibër.

Ndërkohë, Drejtori i njësisë Vendore të shëndetit Publik Dibër, Hasan Manja, në një intervistë të dhënë për mikrofonin e “Bulqiza Tv” jep informacion për situatën në doganën e Bllatës në lidhje me Coronavirusin. Ai shprehet se si në të gjitha pikat doganore në Republikën e Shqipërisë edhe në doganën e Bllatës janë marrë masat nga stafi mjekësor i Dibres për të kontrolluar çdo person që qarkullon përmes kësaj dogane. Janë ngritur grupe pune që shërbejnë me tre turne në masa të rrepta sigurie. Këtu funksionon edhe karantina. Përsa i përket monitorimit është angazhuar një mjek, një ndihmës epidemiolog dhe dy mjekë higjienistë, por deri tani nuk ka pasur persona të dyshuar për koronavirusin.

Drejtori i Shëndetit Publik Dibër shprehet se në doganën e Bllatës kalojnë shumë shtetas nga vende të ndryshme të botës, si grekë, maqedonas, anglezë, amerikanë por dhe italianë. Pavarësisht se në pikën doganore të Bllatës konstatuam se ekziton pika e karantinë, vihet re se aty mungojnë aparatat bashkëkohore për identifikimin e personave me simptomat e prekjes nga koronavirusi, dhe personeli mjekësor operon vetëm me një termometër të thjeshtë.

Nga këshilla e mjekut

TË SHTOJMË KUJDESIN HIGJENIK

Çdo ditë në laboratorë, shkencëtarët po punojnë për të gjetur një vaksinë dhe kurën kundër koronavirusit. Në çdo moment, njerëzit që drejtojnë po marrin masa. Dhe mos harro atë 2 përqindshin, pra edhe njerëzit që sëmuren kanë 98 përqind mundësi për t'u shëruar. Dhe pothuajse e gjithë popullsia ka mundësi maksimale të mos sëmuret.

Ekspertët e parandalimit na thonë të bëjmë disa gjëra që janë shumë të thjeshta, por shumë të rëndësishme:

1-Nëse të vjen të tështish, bëje tek brryli. Në këtë mënyrë ulet mundësia e rrezikut për të përhapur jo vetëm koronavirusin, por çdo virus tjetër që ka të bëjë me rrugët e frymëmarrjes.

2-Laj mirë duart, lart, poshtë e mes gishtave, me sapun të lëngshëm, për më shumë se dhjetë sekonda.

3-Mund të këndosh ndërkohë këngën “shumë urime për mua” teksa lan duart, kështu arrin të kryesh procesin për aq kohë sa duhet e ndërkohë thua diçka të bukur dhe fut brenda në shpirt pak gëzim dhe optimizëm.

4-Përdor kartopiceta për rrufën dhe hidhi menjëherë në një kosh të mbyllur.

5-Mos i vendosni gishtat dhe duart në gojë, sy, hundë (por tashmë e keni ditur këtë!) dhe mos ha thonjtë. Këta mbaji të shkurtër dhe të rregullt. Kjo është gjithçka ajo që mund të bësh ti vetë për të mposhtur këtë përbindëshin e padukshëm që të ka frikësuar. Të cilin po e njohim nga dita në ditë dhe po mësojmë ta mundim.

Njeriu, gjatë gjithë historisë ka ditur si të bëjë gjëra të jashtëzakonshme. Mësoi të kapërcejë sëmundje shumë më të tmerrshme, shpiku raketa që mund të na çojnë në Hënë, zbuloi se si ta shndërrojë ujin dhe dritën e diellit në energji.

Mos harro: Frika na bën të shohim vetëm anën e errët dhe të zymtë të gjërave. Por ti mos humb në errësirë.

Beso! Beso edhe në punën e miliona njerëzve sot që po punojnë dhe po luftojnë për të fituar betejën kundër koronavirusit. Mëso t'i imagjinosh të gjithë sëbashku. Janë një ushtri e pafundme me miliona burra dhe gra – mjekë, studiues, shkencëtarë, infermierë, oficerë të zbatimit të ligjit – kundër një virusi mikroskopik të padukshëm.

Do t'ia dalim edhe këtë herë, do ta shohësh që do t'ia dalim!



ISAKU: PAS REFORMËS ZGJEDHORE, ZGJEDHJE TË PARAKOHËSHME

• *I pranishëm në këtë aktivitet festiv ishte edhe Nënkrjetari i Partisë Demokratike të Shqipërisë, Edmond Spaho, i cili në fjalën e tij vlerësoi punën e kësaj dege. Spaho tha se miratimi i reformës zgjedhore do të çojë vendin në zgjedhje të parakohshme*

Dega e Partisë Demokratike në Bulqizë ka festuar 29 vjetorin e themelimit të saj. Në këtë ngjarje të rëndësishme të kësaj force politike në Bulqizë morën pjesë ish-drejtues të saj ndër vite, simpatizantë, drejtues aktual, drejtues të qendrës, ish deputetë etj. Fjalën e hapjes e mbajti Kryetari i PD Dega Bulqizë, Defrim Fiku. Por fillimisht ceremonia nisi me një minutë heshtje për biznesmenin dhe aktivistin e PD në vite Murat Duriçi, i cili humbi jetën aksidentalisht pak javë më parë. Në vijim zoti Fiku lexoi një përsëritje nga themeluesi dhe kryetari i parë i kësaj dege Z.Bashkim Lami, i cili e kishte të pamundur pjesëmarrjen në këtë festë. Më pas edhe nënkryetari i Degës së PD Bulqizë, Z.Edmond Isaku mbajti një fjalë përsëritëse. Pasi vlerësoi punën përkushtimore të demokratëve të këtij rrethi, z.Isaku u shpreh për domosdoshmërinë e zgjedhjeve parlamentare dhe lokale të parakohshme në një ditë. “Ngjarja më e rëndësishme

politike e këtyre ditëve është reforma zgjedhore ku padyshim kontribut të vlefshëm për të kanë dhënë përfaqësuesit e opozitës jashtëparlamentare në komisionin e ngritur nga Këshilli Politik. Pas këtij ligji rruga e vetme për daljen nga kriza e thellë janë zgjedhjet e parakohshme”,-tha z.Isaku. Ai e vuri theksin te reforma zgjedhore që duhet të jetë plotësisht në përputhje me rekomandimet e OSBE / ODIHR-it. Këtë ka kërkuar dhe Bundestag-u gjerman në rezolutën e tij të 26 shtatorit 2019.

Në këtë takim festiv përsëriti edhe ish deputeti i Qarkut Dibër, Xhemal Gjunksi.

I pranishëm në këtë aktivitet festiv ishte edhe Nënkrjetari i Partisë Demokratike të Shqipërisë, Edmond Spaho, i cili në fjalën e tij vlerësoi punën e kësaj dege. Spaho tha se miratimi i reformës zgjedhore do të çojë vendin në zgjedhje të parakohshme. Nënkrjetari i PDSH Edmond Spaho reagoi me tone të ashpra për qeveris-



jen kriminale të kësaj mazhorance që me korrupsionin galopant e paparëgjeshmërinë e saj i ka shkaktuar

vendit krizën më të thellë dhe të gjithanshme, pasojat e së cilës po i vuanjnjë shqiptarët.

FJALA

Ne kemi një mision historik



(vijon nga fq.1)

Ky projekt strategjik madhor, është implementuar për 29 vjet në kontributin e padiskutueshëm të PDSH-ë për vendin dhe PD-së,dega Bulqizë, për Bulqizën.

Në këtë rrugëtim të vështirë, gjatë kohës që vendin dhe pushtetin vendor e ka drejtuar Partia Demokratike në Bulqizë, në fshat dhe në qytet ka pasur ndërtime rrugësh,ujësjellës, shkolla të rregulluara, ndihmë ekonomike të mirë- administruar, projekte bujqësore-blegtorale- frutore, projekte efçente hidro- energjitike, kushte të përmirësuar në vazhdim në shkolla dhe qendra shëndetësore dhe ndihma të emergjencave civile korrekte. Gjatë qeverisjes së PD- së, në Bulqizë ka pasur mbështetje për shkollim, për zhvillim dhe infrastrukturë. Pjesa më e madhe e ish- komunave sot kanë rrugë ndërfsattrash me qendrën dhe rrugën nacionale të shtruara me standarde të mira, falë politikës së PD-së,për fshatin,zonave rurale dhe qytetin.

Në 29 vite Partia Demokratike e degës sonë ka bilanc pozitiv, pasi në çdo legjislacion ne i kemi dhënë mbështetje të fortë në kuadër kombëtar votës së PDSH-së, për të qenë faktorë të rëndësishëm në fitoret e saj. Me këtë rast, demokratët e Bulqizës do të falenderojnë gjithmonë drejtuesit e PD-së, të degës sonë, z. Petrit Shehu, Latif Dema, Gëzim Dumani, Veli Losha,Agim Kaçani, Gëzim Dauti, Roland Keta, Durim Balla dhe De-

frim Fiku.

Së bashku kemi përballuar jo vetëm sfidën e zhvillimit, që ka qenë një zhvillim yni i brendshëm, por përballja me babëzinë e formacionit tradicional-politik, sigluar së fundmi me emrin “rilindje”, të sektit më të kamufluar të ish Partisë së Punës, e cila ka prodhuar qeveritë më të korruptuara të të gjithë historisë së vendit, gjuhën e drunjtë me zhvillimin dhe nxjerrjen në skenë të një klani kriminal, të oligarkisë financiare dhe në Bulqizë,si në të gjithë vendin. Gjatë 7 viteve, si dhe sot, ne kemi luftuar të përçojmë mesazhin dhe të jemi misionarët e programit politik-ekonomik-social dhe historik të PDSH-së, që ditën e parë kur ajo u krijua.

Në këto rrethana, PD, dega Bulqizë, ka qenë dhe mbetet aktive, një faktor i rëndësishëm i opozitës së vendit, pjesë e misionit të shenjtë,- ruajtjen me çdo kusht të demokracisë, lthimin e normalitetit dhe funksionimin e saj. Mbështetja që ne i kemi dhënë dhe po i japim aksionit opozitar,të opozitës kombëtare është shprehja e vullnetit tonë për të njohur nga afër gjithë ç’ ndodh në rrethin tonë, i cili është kapërthyer deri në fyt në korrupsion, në qeverisjen familjare dhe miqësore, në klane të ngushta, në përdorimin e drogës, në abuzimin basdard të financave shtetërore dhe vendore, taksat, në rrënimin e fshatit dhe çdo familjeje të Bulqizës.

Kjo ditë është apel për çdo demokrat. Si 29 vite më parë, vendi është i degraduar, njerëzit janë të trishtuar dhe shpresë vvarë, varfëria është bërë një metastazë kancerogjene në çdo familje, pushteti ka degraduar në çdo qelizë, ndërsa një grusht njerëzish janë super pasuruar. Pra, jemi më keq se 29 vite më parë!

Në këto kushte, ne jemi para një fillimi tjetër, para një misioni tjetër. Duhet të jemi bashkë, me fuqi, qartësi, unitet, mbështetje të kauzës për demokraci për ta arritur atë.

Ne nuk rrëzohemi! Ne nuk mposhtemi! Ne kemi një mision historik para vendit, popullit dhe së ardhmes, një mision që do ta arrijmë!

Rroftë Partia Demokratike!

Me vlerësim të plotë për çdo demokrat!

Defrim Fiku

Kryetar i Degës së PD Bulqizë

(Fjala në takimin festiv me rastin e 29-vjetorit të krijimit të Degës së PD Bulqizë)



Dega e Partisë Demokratike
Mat feston 29 vjetorin e
themelimit të saj

**Në PD, njerëz
me vlera të larta
shoqërore**

Në një atmosferë festive, Dega e Partisë Demokratike Mat, ka përkujtuar 29 vjetorin e themelimit të saj. Në aktivitetin e organizuar për këtë ditë, morën pjesë drejtues të kësaj force politike në Mat, themelues të saj 29 vite më parë, ish deputet të PD, drejtues të kësaj force në Bulqizë etj. Kryetari i Partisë Demokratike Mat, Arjan Lika, duke vlerësuar sakrificën e demokratëve të Matit vitin e kaluar, tha se kjo parti është më e fortë se kurrë dhe se brenda saj ka njerëz me vlera të larta shoqërore.

Ish Deputetja Dhurata Çupi tha se kauza e opozitës për zgjedhje të lira dhe të ndershme, koha e tregoi se ishte e drejtë.

I pranishëm në këtë aktivitet, Kryetari i Forumit Rinor të Partisë Demokratike, Belind Këlliçi tha se është momenti që të rinjtë e Matit, të bëhen bashkë për kauzën e drejtë. Anëtar i Kryesisë së Partisë Demokratike, Krehsnik Çollaku krahasoi shembjen e regjimit komunist 29 vite më parë, me nevojën për të bërë të njëjtën gjë edhe sot.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin edhe ish Deputeti Xhemal Gjunksi, Kryetari i PD Bulqizë Defrim Fiku e nënkryetari Edmond Isaku.

Shqiptarët më të bashkuar se kurrë në mbrojtje të Kushtetutës dhe shtetit ligjor

protesta

Kjo mazhorancë ka tejkaluar çdo limit, por një ditë Shqipëria do të bëhet

2 Marsi ishte ditë vendimtare për mbrojtjen e Kushtetutës. Në manifestimin popullor të thirrur nga Presidenti i Republikës Sh.T.Z. Ilir Meta Ilir Meta morën pjesë qindra mijëra qytetarë nga gjithë vendi, që mbushën tej e përtej Sheshin "Nënë Tereza" dhe gjithë Bulevardin "Dëshmorët e Kombit".

Tubimi i thirrur nga presidenti Meta u hap nga aktori Neritan Liçaj i cili tha se ky manifestim është më i madhi në vend dhe ka ngjyrat kuqezi. 'Jemi këtu në mbrojtje të atdheut tonë të dashur Shqipëri, si asnjëherë tjetër kundër grushtit të shtetit', tha ai ndër të tjera.

Ish anëtari i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe profesori i universitetit të Salzburgut, Ledi Bianku tha se 'në një vend ku nuk ka Gjykatë Kushtetuese nuk mund të flitet për demokraci dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut. Pa një gjykatë nuk kemi forcën e ligjit, por ligjin e forcës përfshirë edhe në interpretimin e Kushtetutës'

Ndërsa ish Ambasadori shqiptar në OKB, Agim Nesho tha se të gjithë janë këtu për të kërkuar një Shqipëri demokratike, ku sot është kapur nga krimi dhe autokracia e pushtetit.

'Të kesh demokraci është zgjedhja jonë, të mbrosh është detyra jonë. Të gjithë duam një Shqipëri demokratike, me të drejtat tona të respektueshme, që fëmijët tanë të jenë krenarë të punojnë këtu. Sot Shqipëria është më e plakur, është vrarë shpresa për të ardhmen, polarizimi i ekonomisë, autokracia e pushtetit, lidhjet e krimin të politikën, në një vend ku regjimi një partiak ka kapur institucionet, por llogaridhënia me popullin janë tretur në propagandë ku transparenca mungon. Kemi refuzuar zgjedhjet njëpar-



tiakë të 30 qershorit. Sot jemi para shkeljes së Kushtetutës, aktit të madhor për të ardhmen e vendit. Kapja e institucioneve është vija e kuqe për të mbrojtur demokracinë. Mund të kemi menduar se lufta politike është luftë interesash, por e sotmja është kampanë alarmi për mbrojtjen e Kushtetutës dhe kthimin e sovranitetit', tha Nesho.

Për studentet e drejtësisë, Oneda Skenderi kryeministri Edi Rama ka tejkaluar çdo kufij dhe për këtë ka listuar një sërë argumentesh, që sipas saj legjitimojnë këtë tubim të thirrur nga presidenti Ilir Meta.

"Të mos respektohet parimet e shtetit të së drejtës është të kalosh kufijtë, të lësh vendin pa Gjykatë Kushtetuese, të mohosh njerëzve të drejtën për t'u shprehur dhe t'u mbyllësh gojën medias, të lësh shpresë familje. Prandaj për t'i thënë ndal atyre që sheklin Kushtetutën jam këtu që zëri i sovranit të dëgjohet dhe do të dëgjohet. Të gjithë studentët e drejtësisë në

vitin e parë njihen me parimet e shtetit të së drejtës dhe hierarkinë e normave. kushtetuta është mbi gjithçka dhe mbi këto, e paprekshme. Nëse do më pyesnin për të arfërit e mi do ju thoja se ato janë larguar, profesionistët po largohen, popullsia po plakët. Mjaft më papërgjegjshmëri, me pasiguri, është e drejta e këtij sovranit të kërkojë një jetë të dinjitetshme. Një ditë Shqipëria do të bëhet", tha ajo. Studentja e drejtësisë deklaroi se kryeministri Rama ka tejkaluar çdo limit... por një ditë Shqipëria do të bëhet

Regjisori Bujar Kapexhiu tha nga podiumi i ngritur në tubimi se të gjithë shqiptarët duhet të ngrihen kundër atyre që tentojnë të prekin dhe shkelin ligjin për interesa të ngushta personale. 'Mallkuar qofshin ato që shpikën shuplakat dhe të gjithë se bashku të mbrojmë Kushtetutën. Mos u gënjeni nga politika që është e mbushur me pinokë gënjeshtarë dhe hundëgjatë. Nuk ka rëndësi se kush e

ngriti këtë podium sot Meta, më parë kanë qenë Rama e Berisha, por ajo që ne dalim për të mbrojtur, Kushtetutën.'

Boksieri Kristjan Demaj ka mbajtur një fjalim të shkurtër në podiumin e ngritur përballë presidencës. Fitoren si kampion ndërkombëtar shprehet se ia dedikon pikërisht 2 marsit.

"Jam i lumtur që ndodhet këtu në këtë manifestim madhështor., Vij pas një fitore të titullit si kampion ndërkombëtar, vetëm para tre ditësh. Ia dedikoj kësaj dite të shenjtë, 2 marsit. Edhe pse nuk kam lindur këtu, zemra ime është kuqezi, rreh për këtë vend të mrekullueshëm, që nuk duhet ta lëmë të shpopullohet, për këtë rini që të ndërtojmë të ardhmen këtu, shqiponjat duhet të kthehen në folenë e tyre. Sot është ditë e shqiponjave. Beteja për Kushtetutën është beteja për të ardhmen tonë", tha ai.

Regjisori Edmond Budina ka qenë më i ashpër në fjalimin e tij. Si një ish-emigrant, artisë, Buda shprehet se kjo ditë do të jetë e rëndësishme për të realizuar ëndrrën prej 30 vitesh.

"Rikthehem pas 30 vitesh për të luftuar për drejtësisë. Kam qenë emigrantë dhe e di se çdo të thotë të të vdesin prindërit dhe të mos i shikosh, të shikosh parlamentit ku deputetët vishen me rroba firmato, kur pensionistët nuk kanë para për të paguar ilaçet. Salet sulltani që mundohet të vendosë sulltanatin e tij nuk do ia dalë kurrë të zbrazë Shqipëri. 30 vite më parë kishte ëndërr që Shqipëria të bëhej si Europa, ne do e bëjmë duke zhdukur këtë oktapod", tha Budina

Pas dy orësh është mbyllur tubimi i presidentit Ilir Meta. I gjithë tubimi ka vijuar paqësisht, një gjë për të cilën doli garant dhe presidenti Meta, ku si simbol ishin lulet e mimozës dhe flamujt kuqezi.

Presidenti Meta: Presidenca i vetmi institucion legjitim. Ulem në gjunjë para popullit kuqezi

Në fjalimin e tij në podiumin e vendosur përballë presidencës, kreu i shtetit tha se përkulet para popullit që e thirri si president në mbrojtje të Kushtetutës, dhe jo si Ilir Meta.

"Presidenti i popullit kuqezi ulet në gjunjë vetëm para flamurit kuqezi dhe popullit kuqezi. Para popullit të shqiponjave. Këtë ta dëgjojnë mirë puçistët vendas dhe organizata ndërkombëtare mafioze që kërkon të shkatërrojë sovranitetin dhe kushtetutën tuaj. Neni 2 i Kushtetutës që ju votuat në referendum në '98 thotë sovranitetin i përket vetëm popullit. Ndaj ju kam ftuar jo si Ilir Meta, por si presidenti juaj, si i vetmi institucion legjitim demokratik që ka mbetur në këtë shtet për të dëgjuar zërin tuaj. Sepse kur institucionet bien, bie populli. Dhe populli nuk futet në xhep si paratë e oligarkëve. Jemi këtu sepse Shqipëria e sotme është ndarë në dy botë antagoniste, të popullit kuqezi dhe në grupin që përfaqëson një botë të errët, të vogël, meskinë dhe tradhtarë, të puçistëve dhe të oligarkëve, që si shushunja pijnë çdo ditë gjakun e popullit me koncesione e PPP. Jemi vendi i parë në botë për kostot e autostradave për metër katrorë. Unë si president i kam rrëzuar publikisht këto dekrete të arsytuara mbi kushtetutë. Dekrete për koncesionet që kanë vetëm një qëllim, grabitjen dhe jo zhvillimin e Shqipërisë. Kërkojnë rrëmbimin e Gjykatës Kushtetuese që krimet e tyre kushtetuese të mbenin të pagjykuara dhe pandëshkuara. Jemi sot këtu sepse asnjë nga ne nuk mund t'i qëndrojmë anash grushtit të shtetit. Me nisjen e pranverës kuqezi, unë si ushtar i parë i republikës dhe i gjithë populli kuqezi kundër grushtit të shtetit", tha Meta.



META: Sistemi i drejtësisë është kapur për fyti, nga sektori anti-shtet

• *Pse presidenti thirri popullin? Sepse presidenti i shterojnë të gjitha përpjekjet institucionale dhe demokratike për të parandaluar kapjen e shtetit dhe sidomos grushtin e shtetit. Presidenti ka thirrur popullin sepse pasuria kombëtare që po vidhet çdo ditë është ajo ç'ka zoti u ka dhënë të gjithë shqiptarëve*

Gjatë fjalës në manifestimin madhështor të datës 2 Mars 2020 me pjesëmarrjen e qindra mijëra protestuesve nga gjithë vendi, ka sqaruar se pse vendosi të thërriste këtë protestë kundër mazhorancës. Sipas Metës, institucionit të Presidencës i kanë shteruar të gjitha përpjekjet demokratike dhe sipas tij kjo ishte mënyra e vetme për të mbrojtur popullin nga grushti i shtetit. Kreu i Shtetit tha edhe se po vidhet pasuria kombëtare çdo ditë dhe kjo është një nga arsyet e tjera se pse ai thirri këtë manifestim.

DEKLARATA

Pse presidenti thirri popullin? Sepse presidenti i shterojnë të gjitha përpjekjet institucionale dhe demokratike për të parandaluar kapjen e shtetit dhe sidomos grushtin e shtetit. Presidenti ka thirrur popullin sepse pasuria kombëtare që po vidhet çdo ditë është ajo ç'ka zoti u ka dhënë të gjithë shqiptarëve. Sepse sistemi i drejtësisë është kapur për fyti, nga sektori anti-shtet, sepse kemi drejtësi me regji që godet të varfërit të pambrojturit dhe të ndershit dhe garanton paprekshmërinë e klaneve pranë sektit që ka zaptuar shtetin. Sepse financat publike po rriten në mënyrë katastrofike dhe ato po i paguan të gjithë në mënyrë të padrejtë. Sepse skandalet që financon kontrolli i lartë i shtetit prej miliarda eurosh bie në vesh të shurdhët edhe për qeverinë edhe për Kuvendin, por edhe për drejtësinë që fle.

PRESIDENTI META FLET PËR GRUP PUÇIST: PINË SI SHUSHUNJA GJAKUN E POPULLIT

Presidenti i Republikës, Ilir Meta gjatë fjalës në manifestimin e thirrur prej tij në mbrojtje të Kushtetutës më 2 mars, u shpreh se ulet në gjunjë vetëm para popullit dhe flamurit kuq e zi dhe nuk përulet para asnjë grupi puçist.

Meta theksoi se sot Shqipëria është



ndarë në dy botë, atë kuq e zi dhe një grup i vogël i errët që i pi gjakun shqiptarëve si shushunja.

“Presidenti i popullit kuq e zi ulet në gjunjë vetëm para popullit dhe flamurit kuq e zi. Para popullit të shqiponjave. Këtë ta dëgjojnë mirë puçistët vendas dhe organizata ndërkombëtare mafioze dhe kërkon të shkatërrojë sovranitetin e kushtetutës suaj. Neni 2 i kushtetutës që ju votuat në 98 thotë: Sovraniteti i përket vetëm popullit.

Ndaj ju kam ftuar jo si Ilir Meta por si presidenti juaj, si i vetmi institucion legjitim, demokratik për të dëgjuar vendin tuaj sepse kur institucionet bien ngrihet populli dhe nuk futet në xhep si paratë e oligarkëve.

Jemi këtu sepse Shqipëria është ndarë në dy botë. Ne atë të popullit kuq e zi dhe në atë të grupit që përfaqëson një botë të errët, tradhtarë, puçistë të oligarkëve, që si shushunja pinë çdo ditë gjakun e popullit tonë.

Unë si President i kam rrëzuar publikisht këto dekrete, pa dekrete për koncesion, që i kanë vetëm një qëllim, grabitjen e Shqipërisë, ata tani kërkojnë edhe rrëmbimin e Gjykatës Kushtetuese në mënyrë që oligarkët të fitojnë sa më shumë dhe krimet e tyre Kushtetuese të mbeten të pandëshkuara. Jemi këtu sepse asnjë nga ne

nuk mund t'i qëndrojnë anash grushtit të shtetit. Jemi këtu, për t'u vendosur përballë sot, me nisjen e Pranverës së kuqezi, unë si Presidenti i Republikës dhe ushtari i parë i Republikës, kundër grushtit të shtetit.

Pse Presidenti thirri popullin, sepse i shteroi të gjitha përpjekjet institucionale për të parandaluar kapjen e shtetit dhe sidomos grushtin e shtetit. Presidenti thirri popullin sepse po i vidhet çdo ditë ajo që Zoti i ka dhënë të gjithë shqiptarëve, sepse kemi drejtësi me regji, që godet të varfërit, të pambrojturit dhe garanton paprekshmërinë e klaneve pranë sektit që ka zaptuar shtetin. Borxhet po rriten në mënyrë katastrofike dhe epo i paguani jo me pa të drejtë.

Sepse skandalet që e denoncon KLSH, prej miliarda eurosh bien në vesh të shurdhët për qeverinë, Kuvendin dhe Drejtësinë që fle, sepse ekonomia juaj është në ditët më të errëta, oligarkët kontrollojnë parlamentin”, tha Presidenti Meta.

META FIRMOS DEKRETIN E PARË

Presidenti Ilir Meta firmosi para qindra mijëra qytetarëve shqiptarë pjesëmarrës në protestën e 2 marsit dekretin kundër ligjit që i hoqi presidentit kompetencën për betimin e gjyqtarëve të rinj kushtetues. ndërsa tha se qytetarët i kërkuan të firmosë edhe një dekret për shpërndarjen e parlamentit. Ai tha se do ta bëjë këtë më pas.

“Jam i lumtur se kushtetuta e popullit ka sot në këtë shesh popullin e kushtetutës. Përpara se të firmos dekretin kundër ligjit antikushtetues për betimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese. kush është pro ju lutem të ngre dorën. Rroftë Republika, rroftë shteti i republikës. Këtu ka një kërkesë tjetër, nuk kënaqen me kaq. Duan që sot shpërndarjen e parlamentit puçist. (Brohorima nga turma). Liri, demokraci. Më duhet të firmos këtë dekret dhe do të kthehem përsëri këtu për

atë dekretin tjetër që e brohoritet me shumë se ky”, tha Meta teksa u ul në një tryezë vendosur në podiumin ku u mbajtën fjalimet, dhe vuri firmën mbi dekret. Presidenti Ilir Meta tha se pas 15 marsit do të firmos në të njëjtën mënyrë, para popullit, dekretin për shpërndarjen e parlamentit. Meta akuzoi ndërkombëtar se ndër vite kanë funksionuar si një organizatë kriminale që kanë luajtur me sovranitetin e popullit shqiptar. Meta kërcënoi se nëse ky dekret që paralajmëroi ta firmosë pas 15 marsit nuk do të merret seriozisht nga mazhoranca dhe ndërkombëtarët, do të mësyjë parlamentin duke e firmosur me popullin brenda kuvendit që sipas tij është ilegjitim.

QYTETARËT THIRRJE PRESIDENTIT META: SHPËRNDAJE, SHPËRNDAJE PARLAMENTIN

Teksa Presidenti Ilir Meta mbante fjalim, në tribunën e mitungut madhështor të 2 marsit qytetarët kanë thirrur në kor “Shpërndaje, shpërndaje Parlamentin”. Kreu i Shtetit gjatë fjalës në podium para njerëzve të mbledhur në shesh ka renditur arsyet se pse e thirri këtë protestë. Ai tha se drejtësia është kapur prej fyti dhe se ajo bëhet me regji nga sektori anti-shtet.

‘Kjo pranverë kuqezi nuk ndalet më’, Meta: Mos u jepni alibi puçistëve, mimosat dhurojani policëve

Presidenti Ilir Meta në mbyllje të fjalës së tij bëri thirrje për mos të krijuar incidente për të mos i dhënë alibi puçistëve, ndërsa tha se mimosat të mos i hedhin drejt institucioneve por t’ua dhurojnë policëve.

‘Jemi populli që vuajti më shumë se kushdo komunizmin. Jemi ku u varën klerikët e hoxhallarët. Jemi një popull që jetën e japim por demokracinë jo. Shumë prej jush mund të kenë patur vërejtje për tonin tim, e di, por unë në publik nuk kam treguar as 10% të krimeve që kanë ndodhur kundër sovranitetit tuaj dhe reformës në drejtësi. Kjo pranverë kuqezi nuk ndalet më, deri në rivendosjen e sovranitetit tuaj dhe rikthimin e ligjit. me qetësi dhe drejtësi, e gjithë bota demokratike dhe partnerët me integritet që kanë respekt për popullin tonë. Nuk mund të kesh respekt për popullin tonë nëse vepron me qeveritarët që kanë kapur ligjin. Mos i jepni alibi puçistëve. Asnjë mimosë mos hidhni tek institucionet, por dhurojani policëve tanë kudo që ti takoni. Nga sot në të vetmin institucion kuqezi nis marshimi i popullit kuqezi. Zëri i popullit, zëri i zotit. Jemi një popull shqiponjash dhe ato fluturojnë vetëm lartë. Falënderim për bashkatdhetarët që erdhën nga Amerika dhe nga e gjithë bota’, tha Meta



Presidenti Meta kishte në krahun e tij gjatë protestës së 2 marsit, edhe një vajzë simpatike nga Bulqiza

profil

Oneda Skënderi : “Ndal” atyre që shkelin të drejtat tona dhe Kushtetutën

Në fjalën e saj në podium ajo tha se të mos respektosh parimet e shtetit të së drejtës dhe funksionimin e tij, është të kalosh kufijtë

Studentja ekselente e drejtësisë, nga Bulqiza,

ONEDA SKËNDERI

Presidenti i Republikës Sh.T.Z.II-ir Meta kishte në krahun e tij gjatë protestës madhështore të 2 marsit, edhe një vajzë simpatike nga Bulqiza.

Ajo quhet Oneda Skënderi dhe është student e drejtësisë.

Oneda u bë e njohur gjatë protestës së studentëve.

Por nga tribuna e këtij manifestimi madhështor, ajo tha se ka dalë të mbrojtë vendin si një idealiste.

“Sot jam këtu jo si ndonjë përfaqësuese e ndonjë partie politike, por si një e re idealiste që nuk do ta braktisë vendin për shkak të paaftësisë apo mungesës së vizionit të disa politikanëve.

Të mos respektosh parimet e shtetit të së drejtës dhe funksionimin e tij është të kalosh kufijtë.

Të lësh vendin pa Gjykatë Kushtetuese është të kalosh kufijtë.

Të mos lësh funksionimin e tre sistemeve është të kalosh kufijtë, të intimidosh mediat, të mos ofrosh shpresë për familjet shqiptare, të rinjtë shqiptarë është të kalosh kufijtë.

Ndaj jam këtu që zëri i sovranit të dëgjohej dhe do dëgjohej medoemos”, u shpreh ajo.

Studentja e drejtësisë, nga Bulqiza, Oneda Skënderi tha se ishte në manifestimin madhështor të Datës 2 Mars në kryeqytet për t’u thënë ndal atyre që shkelin Kushtetutën dhe të drejtat e qytetarëve. Në fjalën e saj në podium ajo tha se të mos respektosh parimet e shtetit të së drejtës dhe funksionimin e tij, është të kalosh kufijtë.

“Jam studente e Fakultetit të Drejtësisë, jam këtu në emër të të rinjve që ëndërrojnë të ndërtojnë jetën e tyre mnë Shqipëri. Në tetor të 2018-tës ne u ngritëm në protestë për një Shqipëri më të mirë, dhe u mashtruar me demagogji dhe premtime boshë.

Sot jam këtu jo se i përkas një partie politike, por si një e re që e do vendin e saj.

Faik Konica do të shkruante se disa broçkulla edhe u falen politikanëve, por nuk mund të kalosh kufinj të. Të lësh vendin pa gjykatë Kushtetuese është të kalosh kufinj të, të lësh të rinjtë oa shpresë është të kalosh kufinj të, ndaj duhet tui themi ndal atyre që shkelin Kushtetutën, jam këtu që zëri i sovranit të dëgjohej me doemos.

Të gjithë studentët e drejtësisë njihet me hirearkinë e normave dhe Kushtetuta e Shqipërisë është mbi të gjitha dhe është e paprekshme. Mjaft më me pasiguri, ësghtë e drejta e këtij sovranit që të kërkojë barazi përpara ligjit, zoti e bekoftë



Shqipërinë, dje iu ktheftë shpresën shqiptarëve, se PO, Shqipëria një ditë do të bëhet”, u shpreh studentja e drejtësisë.

Studentja që u shfaq krah Presidentit Ilir Meta gjatë manifestimit të 2 marsit është e bija e gjyqtarit të Vladimir Skënderi, ish kuader në minierën e kromit Bulqizë, me

origjinë nga Gjorica. 21-vjeçarja ka marrë pjesë edhe në protestën e studentëve. E ftuar vetëm një ditë pas protestës së 2 marsit në mbrojtje të Kushtetutës në emisionin “Ftesë në 5”, (Tv.Top Chanal) Oneda u shpreh se në manifestim mori pjesë si idealiste për të mbrojtur kushtetutën.

Oneda bëri të ditur për publikun

në “Ftesë në Pesë” se nuk është pjesë e një partie politike dhe nuk mendon të jetë. Fjalimi ishte thjesht një detyrim, të cilin ajo e ndjeu ta bënte si pjesë e të rinjve që e duan Shqipërinë dhe kanë vendosur të jetojnë këtu. “Nuk ka asgjë të keqe të anëtarësohesh në parti politike, por këtu nuk kanë emër shumë të mirë dhe personalisht mendoj se nuk do të përfshihem ndonjëherë. Thjesht do të ndjek gjithmonë të gjitha protestat dhe mitingjet që në thelb kanë diçka të drejtë, pavarësisht se nga kush organizohen. Rëndësi ka kauza. Shoqëritë demokratike të shëndetshme janë ato që kanë përplasje idesh, kanë debate,” u shpreh Skënderi. Studentja e Fakultetit të Drejtësisë, Oneda Skënderi, është një ndër studentet më të dalluara në këtë faktultet. Ambicia e saj është të vazhdojë studimet master në Londër dhe më pas të gjitha nivelet e shkolimit për drejtësi.

Përveç inteligjencës, Oneda është edhe një vajzë mjaft bukuroshe.

Ajo ka qenë mjaft aktive edhe në protestën e studentëve në dhjetorin e 2018.

Basha në tubimin e Metës: Liria rrënohet kur kushtetuta shkelet!



Lideri demokrat Lulzim Basha i është bashkuar tubimit të president Ilir Meta më 2 Mars, duke dalë jo nga zyra e tij në selinë e PD-së, por nga kafja e hotel Rogner, ku më herët kishte takuar ambasadorin amerikan Yuri Kim.

“Mesazhi im është një falënderim nga zemra për gjithë qytetarët që i janë përgjigjur thirrjes për të mbrojtur Kushtetutën. Le të citojmë sot një prej baballarëve themelues të SHBA Thomas Jefferson: e vetmja garanci për ruajtjen e lirisë është mbrojtja e Kushtetutës dhe se liria dhunohet, kur Kushtetuta shkelet. Në Shqipëri kushtetutës i ka mbetur vetëm kapaku. Mendoj se kriza politike duhet zgjidhur një orë e më parë për Shqipërinë dhe shqiptarët dhe se e vetmja zgjidhje janë zgjedhjet e parakohshme parlamentare në një ditë me zgjedhjet legjitime vendore. Kjo nuk është një protestë, është një tubim drejtuar

gjithë qytetarëve shqiptarë në mbrojtje të Kushtetutës dhe unë këtu ndodhem si qytetar, si prind, si bir nëne e babai, si bashkëshort dhe si bashkëqytetar i juaji. Unë kam dalë bashkë me miq të nderuar, me zotin Mustafaj, me zotin Bisha dhe miq të tjerë për të dhënë mesazhin e qartë se ky është tubim qytetar. Thirrja u është drejtuar qytetarëve dhe ky është një bashkim qytetar”, tha Basha.

Krah kryedemokratit Lulzim Basha, janë parë në tubimin e presidentit Ilir Meta, edhe figura të tjera të opozitës si Fatmir Mediu, Besnik Mustafaj, si dhe kreu i FRPD, Belind Këllici.

Në këtë protestë nuk ka munguar edhe kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi. Ajo është parë përballë kryeministrit të bashku me ish-deputetë të LSI-së, larg podiumit ku u mbajtën Ajo ka deklaruar se i bashkohet tubimit si qytetare dhe jo si kryetare e një partie politike.

Të gjithë së bashku për Kushtetutën, për të ardhmen...

**PROF. BUJAR KAPEXHIU
NDERI I KOMBIT***

Të nderuar motra dhe vëllezër, bashkatdhetarë të mi të çmuar e të shtrenjtë!

Jemi mbledhur sot këtu së bashku për dy veprime, për dy detyra: të mbrojmë dhe të mos pranojmë. Për mbrojtje të ligjit, të së vërtetës, të progresit e të moralit; dhe më shumë kundër së keqes, regresives, gënjeshtres e babëzisë.

Nuk kam qenë kurrë anëtar i ndonjë partie politike e nuk do të jem kurrë. Por, në të njëjtën kohë, në çaste të veçanta jam ndjerë njëkohësisht edhe demokrat edhe socialist, republikan, legalist e ballist. Pikërisht në ato çaste kur është fjala dhe veprimi vetëm në të mirë të Shqipërisë, vetëm në interes të atdheut tim.

Përherë në jetë kam hedhur hapin sipas një divize: "Jam me të gjithë e kundër të gjithëve." Ja dhe sot, në këto çaste jam me të gjithë, me të gjithë ju që jeni në mbrojtje të ligjit, të Kushtetutës, në mbrojtje të dokumentit themelitar të shtetit të lirë e demokratik. Jam njëkohësisht kundër të gjithë atyre që tentojnë të prekin, shkelin, deformojnë, falsifikojnë e tjetërsojnë ligjet themelore për interesa të ngushta personale apo të një grupi të caktuar. Ne morëm më të keqen e diktaturës dhe po shpikim më të keqen e demokracisë. Ne kemi zgjedhur t'i japim këtë pamje Shqipërisë. Por, edhe nëse nuk e kam zgjedhur unë, e ka zgjedhur një miku im, një fqinji im, apo dikush tjetër që nuk është këtu sot. Ai është unë. Ai donte që Shqipëria të ishte kjo. D.m.th. unë kam zgjedhur që Shqipëria të ishte kështu. Unë kam ngrënë 1 milion shuplaka, që vendi im të ishte ky dhe ne kemi dhënë 1 milion shuplaka që ta bëjmë Shqipërinë këtë që është sot.

Pse duhet të themi shuplakë për humbësit e nuk themi 1 milion puthje për fituesit?

Mallkuar qoftë ai që shpiku shuplakën!

U bëj thirrje të gjithë intelektualëve partiakë, intelektualëve të pavarur, intelektualëve të vërtetë, të mençur e patriotë, që, të gjithë së bashku, të mbrojmë atë që është e drejtë, e vërtetë, e ligjshme, të mbrojmë Kushtetutën. Të gjithë ne, ne që jemi sot këtu në shesh e të gjithë ata që ndodhen kudo brenda kufijve të Shqipërisë, jetojmë, marrim frymë mbi



një grumbull gërmadhash të gënjeshtrevave të mëdha. Tani ne jemi një vend i lirë e demokratik, gëngehemi, jemi vend demokratik çalaman me gunga diktatoriale. Jemi një vend pluralist, gëngehemi, jemi një vend njëpartiak. Jemi një vend me progres ekonomik, gënjeshtër! Jemi vendi më i varfër, më i rrënuar, më i sflitur, çdo ditë në braktisje... çdo ditë drejt boshllëkut. Në çdo fushatë elektorale, gëngehemi. Në çdo kongres, gëngehemi. Në çdo intervistë, apo seancë parlamentare vetëm gënjejnë. Politika e mbushur me pinokë gënjeshtarë hundëgjatë. Prandaj, miqtë e mi, ju bëj thirrje: Mos u gënjeni! E vërteta mbrohet vetëm nga zëri juaj, nga vullneti juaj, gjoksi, shpirti, e, pse jo, po të jetë nevoja dhe nga grushti juaj. Të gjithë së bashku të veprimi për të vërtetën, për Kushtetutën.

Politikanë të të gjitha ngjyrave, formave apo kallëpeve, të shkurtër e të gjatë, të gjithë atyre që tashmë janë të shënjuar, injorantë e bastardë, hajdutë e kriminelë, gënjeshtarë e të babëzitur, sharlatanë, mjaft më! U bëj thirrje të braktisin karriget politike të vjedhura, se ndryshe do të përballen me zemërimin e sovranit e të na lënë të lirë e të qetë të jetojmë e të gëzojmë begatinë e këtij vendi ku lindëm e duam të vdesim.

Ky është një podium që e ka ngritur këtu presidenti Ilir Meta. Herë tjetër ka qenë i Sali Berishës, i Edi Ramës, i Lulzim Bashës... Pikërisht këtu, pikërisht

për të njëjtën arsye, për të mbrojtur demokracinë. Po ç'rëndësi ka se podiumi i kujt është, kur ajo që dua të them është se... Unë dua... Unë kam një ëndërr, ëndërrën e një vendi ku njerëzit nuk i japin nga një shuplakë njëri-tjetrit kur zgjedhin të ardhmen e tyre. Nuk qëllojnë me shuplakë sepse duan një jetë më të mirë. Unë nuk dua të qëlloj e të më qëllojnë që e kaluara e jetës pa jetë të kthehet, me një pamje tjetër.

Sa bukur do të ishte sikur sot, kur të

kthehemi në shtëpi, t'i premtim vetes në heshtje: unë s'do të godas më, unë s'do të godas më, unë s'do të godas më!

Miqtë e mi!

Të veprimi të gjithë së bashku, për ligjin, për Kushtetutën, për të ardhmen, për veten, për fëmijët tanë, për Shqipërinë!

Faleminderit!


**Fjala e mbajtur në protestën e 2 Marsit, e thirrur nga Presidenti i Republikës, ShtZ Ilir Meta*

Kriza minerare, shtohet numri i punëkërkuësve të papunë në Bulqizë



Sektori minerar është zhytur në një krizë të thellë të mungesës së shitjes për shkak të rënies drastike të çmimit të mineralit të kromit në tregun ndërkombëtarë. Shumë subjekte kanë përgjysmuar pagat e punëtorëve e të tjera i kanë larguar fare nga puna. Kjo është refeltkuar edhe në rritjen e numrit të punëkërkuësve të papunë në Zyrës së Punës në Bulqizë. Dre-

jtoresha e këtij institucioni Jetmira Doda tha se rritja ka ardhur në muajt e fundit të vitit të kaluar dhe muajt e parë të këtij viti. Doda tha se aktualisht marrin pagesë papunësie 68 persona të dalë nga sektori minerar dhe ky numër pritet të rritet në vazhdim. Po ashtu drejtoresha e Zyrës së Punës Bulqizë, Jetmira Doda tha se deri tani personat e paraqitur nga sektori minerar janë 50% burra e 50% gra, numër i cili mund të ndryshojë për shkak se në minjera numrin më dominant e kanë burrat. Rënia e ndjeshme e çmimit të kromit në tregun ndërkombëtarë, pritet ta thellojë edhe më shumë problemin e largimit të minatorëve nga puna në të gjitha subjektet minerare të Bulqizës.


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI

Tiranë, më 6 mars 2020

Të nderuar miq të shoqatës "Bashkësia Dibrane"

Ju falënderoj për zemërsisht për mbështetjen, bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen tuaj të rëndësishme në manifestimin mbarëkombëtar për mbrojtjen Shtetit Shqiptar, Kushtetutës së Republikës, Lirive e të Drejtave Qytetare, Demokracisë, Medias së Lirë dhe Dinjitetit Njerëzor të Shqiptarëve.

Me solidaritetin tuaj treguat se shpirti dhe ideali i shqiptarëve për shtet të drejtë, liri, demokraci e jetë dinjitoze nuk është mposhtur!

Beteja jonë mund të jetë e vështirë, por po ju kujtoj se idetë janë armët më të fuqishme kur bëhen pjesë e ndërgjegjes së popullit!

Manifestimi 2 Marsit tregoi se qytetarët shqiptarë besojnë tek forca e tyre për ti thënë ndal kapjes së shtetit, korrupsionit, varfërisë e shpopullimit.


Të dashur miq,

Askush nuk mund ta ndalë Pranverën Kuq e Zi të sjellë në çdo vatër shqiptare aspiratën e shumë kërkuar për një Shqipëri të drejtë, të begatë dhe të dashur për të gjithë

Beteja vazhdon deri në vendosjen e plotë të sovranitetit të popullit tonë ndaj të gjithë institucioneve qendrore dhe vendore.

Qeveria do të ketë frikë nga populli dhe jo populli nga qeveria.

Përsëritet për të gjithë ju dhe familjet tuaja!


Ilir Meta

Në vlerësim të heronjve të nëntokës,
në përvjetorin e Minierës së Kromit
Bulqizë

reportazh

Vlerësim heronjve të nëntokës së Bulqizës

ABDURAHIM ASHIKU*

Gjakhumbur e jetë harruar, mbledhur në një libër që tash pesë vjet askush, nga ata “kushët lart”, nuk e ka marrë në dorë, pa le ta shfletojë, të lexojë jetët e të kërkojë gjakun pikuar e rrjedhë honeve të errëta të nëntokës.

Mbase ky libër duhet të ishte (dhe të jetë) në tryezën e atyre që “shkruajnë e shuajnë germa e fjalë” në tepër të përfolurin “projekt-ligj” në këto 27 vite... “Statusin e minatorit”!

Ymer Keta, minator, shkrimtar, publicist NJERI me germa kapitale duke iu drejtuar në 65 vjetorin e Minierës së Kromit të Bulqizës, lexuesve (mirë do të ishte t’i drejtohej Kuvendit) shënon:...

“Në ato ditë të vështira, kur pushka me gjalmë kërciste në male për çlirimin e vatanit e gjaku i derdhur mbushte lumenj, nuk pati më shumë viktima se sa në Minierat e Kromit Bulqizë e Batër, apo edhe në ato të bakrit e të qymyrit, pas çlirimit, lubi e pangopur në jetë njerëzish varrosën minatorë në galeritë e nëntokës, por edhe në sektorë të mbitokës jo pak djem nënash nga zonat e Dibrës, të Matit, të Mirditës dhe nga e gjithë Shqipëria”.

Gazetar e publicisti Sali Ymeri, njohës i minierës së Bulqizës si punonjës i “Avari shpëtimit” duke pyetur se si lindën këto kujtime shkruan...

“E marr me mend se ç’ka përjetuar ky ish minator, sot shkrimtar, në moshën më të bukur, kur ka punuar në galeritë e minierës në vitet 1969-1975, në ato mëngjese, pasdite apo turne nate në ato galeri të frikshme. Autori kujton ato shokë, miq e të afërm, me të cilët përshëndetej në fillim të turnit: “dalshim shëndoshë”!....

DALSHIM SHËNDOSHË!

Një fjali që edhe legjendat dridhen e ngrijnë qelizash rrëfimore. Dalshim shëndoshë!...

Edhe në luftë, në ato beteja që e kanë shkatërruar shoqërinë njerëzore, kjo fjali nuk është shkruar e dëgjuar të dilte nga kordat zanore njerëzore.

Këto 434 faqe libri, me qindra fotografi e skica, afro 500 portrete e emra heronjsh të nëntokës, nuk mund t’i shkruante askush, nuk mund t’i dokumentonte njeri igjallë pa një shpirt të madh, pa sy që shpërthejnë liqenin e lotëve brazdave të pleqërisë, nuk mund t’i dokumentonte askush që nuk e ka përjetuar në shpirt fjalinë “dalshim shëndoshë” sa Ymer Keta.


Nuk do t’i bënte vetëm, por me miq e me shokë jetuar honesh të errëta të nëntokës së Bulqizës, Batrës, Shkallës, Cërujës, Selishtës, Tërnovës, Rubikut, Kurb-neshit...

E lotët përsëri do të mbushnin fjalët e tregimeve, si në një krua që rrjedh me shkumë...!

Shfletoj librin dhe në sy më vijnë heronj të nëntokës, nga ata që i dhanë jetë e zhvillim dhe nga ata që dhanë gjak të pastër rinor...

Njerëz të lirë që dhanë jetën galerive të kromit...

Njerëz të burgosur që dolën në “liri” në një mënyrë që askujt mos i ndodhtë... Ymer Keta i ka bërë bashkë me



- *Kujtesë/ gjakhumburit e jetëharruarit e minierave në kërkim të floririt...*
- *Njerëz të lirë që dhanë jetën galerive të kromit...*
- *Njerëz të burgosur që dolën në “liri” në një mënyrë që askujt mos i ndodhtë...*
- *Njerëz që kur hynin galerive uronin: “Dalshim shëndoshë”...*

të njëjtin respekt dhe përkushtim...Dhe vijnë e radhiten një nga një...

Xhavit Hatibi dhe Todo Maço që një ditë të ftohtë të 18 shkurtit 1948, në krye të 30 minatorëve nga Mirdita, Mati e Dibra, ndezën fitilat dhe bënë që Mali i Duriçit të jehojë...

FeritAlla, Bujar Pata, Kamber Duriçi, Kujtim Gjoka, Bukurosh Koçi... e të tjerë që i vunë shpatullat ndërtimit të minierës së Bulqizës, fabrikës së pasurimit të kromit e ndërtimeve të mëdha kapitale që çuan në deri NJË milionë e dyqind mijë tonë krom në vit për eksportet shqiptare, flori që ndërtoi Shqipërinë, por nuk arriti kurrë të ndërtojë Bulqizën, Batrën, Krastën, Klosin, Burrelin...

Ymeri, në 434 faqe të “Heronjve të nëntokës”, siç i quan ai, hap një faqe që duhet lexuar germë për germë. Nga të gjithë, por në veçanti nga ata që kanë në dorë dhe në mendje t’i venë ata në pedestalin e lavdisë dhe ta venë veten në hulli të mirësisë...

Pa vështrimin mbi këtë “germë”, të vënë përjetësisht nën tokë dhe pasardhësit e tyre në dy breza...

Pa barazinë e tyre njëlloj me ata që u persekutuan nga diktatura...

Pa një vlerësim në “Nenin 1” të Statusit të Minatorit si heronj që dhanë e nuk morën asgjë...Demokracia për të cilën pushtetarët e lartë të të dy krahëve dhe pjella e tyre Kuvendi nuk do të jetë kurrë demokraci, kurrë barazi në të drejtën themelore të njeriut.

Ministri i financave doli disa ditë më parë dhe deklaroi njohjen e vjetërsisë së të burgosurve për efekt pensioni (nuk e specifikoi në ordinere e politike) “dy vjet për një vit” ?!

Faqeve të gazetave, “lajm të parë” e “listë në vijim” jepen çdo ditë miliarda lekë dëmshpërblime për nipër e stërnipër të të persekutuarve të regjimit të kaluar a thua se edhe ata kanë qenë në punë të detyruar galerive të kromit e bakrit apo të internuar fushave të Myzeqesë. Kjo, deri në atë masë të shkronjës sa njeriu i thjeshtë ka filluar të thotë hapur “Deri kur do të paguaj unë për to?”. Dhe për “kë do të paguaj?” sepse në listat publike marrin dëmshpërblim edhe ata që kanë vvarë, kanë vjedhë, përdhunuar e shkelur ligjet e kohës.

Dhe ndonëse tash një çerek shekulli kërkohen të hapen “dosjet e sigurimit”, asnjëherë nuk është kërkuar të hapen “dosjet e gjyqit”, dosje që me siguri atë që qëlloi policin në kokë për ti marrë jetën nuk do ta cilësonte kush hero e martir të demokracisë...

Nuk e di pse sot, 18 shkurt 2018, mora heronjtë e nëntokës, mallin dhe brengën që lanë pas, vendin e tyre në një kohë pa vend, udhëtova në shkronjë të Ymerit thellësive të nëntokës e majave të maleve, aty ku nxirret flori e atje ku kërkohet flori, atje ku jepet jetë e atje ku humbet jetë...

Nuk e di pse brodha me këto shpirtra që flasin fshatrave të Dibrës me lot në sy në shkronjë të Ymer Ketës që qan për të gjithë por kthehet e qan edhe për vete, për pesë njerëzit e gjakut të tij: Ademin, Bujarin, Mehmetin, Izetin dhe Limanin... që i ka përcjellë me lot e dhimbje në botën pa botë. Nuk e di pse u ndala më shumë Grykës së Madhe e Grykës së Vogël, Fushë Bulqizës e Vajkalit që kanë derdhë mbi gurit e kromit aq gjak sa nuk ka derdhë asnjë fshat i Shqipërisë këto vite lufte pa armë e pa armik...

Nuk e di pse e fiksova shikimin në rrëfenjën për Isuf Sulën që la pas shtatë fëmijë. Pyeta veten ku janë dhe si u rritën ashtu siç pyeta veten për më të riun e nëntorit 2017, Liman Ketën, që iku duke lënë një vocërrak 3 vjeç e një nuse të re në dilemën “Të rrosh apo të mos rrosh”!

I thashë vetes se ai fëmijë, ajo nënë e re duhet të ketë status të plotë me të paktën të barabartë me fëmijën e familjen e një polici rënë në krye të detyrës.

Me pension e hapësirë për studime përballuar nga shoqëria...

Pse jo? Kryeministri të bëhet “Plak i Vitit të Ri” me “thesin e dhuratave” në krah grykave të galerive...

I thashë vetes se boll kemi ngrit grumbuj flori e derdhë lot mbi bare varresh të harruar e të freskët...

Qeveria, e harruara qeveri, të hartojë sa më shpejt ligjin për “Statusin e Minatorit”, dhe Kuvendi ta dekretojë: “Hynë në fuqi menjëherë”.

Kështu mbase ua lehtësojnë paksa barrën e jetës atyre që u dogjën në shpirt për ata që ikën e nuk do të kthehen kurrë.

*Marrë nga gazeta “TELEGRAF”



intervista

Shqipëria po përjeton një krizë identiteti. Shkaqet për amullinë e tre dekadave shpesh ja faturojmë kryesisht sistemit totalitar.

Gëzim Al pion: Reforma zgjedhore dhe arsimit modern, këto e nxjerrin Shqipërinë nga kriza

Prof. Gëzim Al pion nga Departamenti i Sociologjisë në Universitetin e Birminghamit në Britaninë e Madhe, analizon krizën në të cilën ndodhet Shqipëria, diasporën, çështjen Brexit dhe krizën në familjen mbretërore.

Britania e Madhe ka dalë përfundimisht nga Bashkimi European, por dilemat mbeten. Atje jeton dhe punon një emigracion i konsiderueshëm nga Shqipëria, të cilët do të preken drejtpërdrejtë nga ky proces. Gazeta "Shekulli", ka realizuar një intervistë ekskluzive me Profesorin e njohur të Sociologjisë në Universitetin e Birminghamit në Britaninë e Madhe. Prof. Al pion shpjegon situatën në të cilën ndodhet Shqipëria, krizat e saj, e ardhmja sociale dhe niveli qesharak i klasës politike në vend, si dhe ikja e Agron Tufës nga Shqipëria. Prof. Al pion në korrik të këtij viti, do të botojë të plotë librin për humanisten e madhe shqiptare, Nënë Tereza.

Prof. Al pion, Shqipëria gjendet në një udhëkryq të madh. Nga njëra anë kemi sfidën e integritetit për në Bashkimin European, nga ana tjetër kemi krizën politike dhe sfidat sociale, të cilat prekin thellë ekonominë dhe shoqërinë shqiptare. Si e shikoni perspektivën e Shqipërisë në vitet që vijnë?

Shqipëria po përjeton një krizë identiteti. Shkaqet për amullinë e tre dekadave shpesh ja faturojmë kryesisht sistemit totalitar. Monizmi ka fajet e veta por rrënjët e kësaj situatë duhen gjetur si në dekadat e fundit ashtu edhe në të kaluarën e largët. Ne kemi humbur kontakt me thelbin tonë, vetëdijen tonë, dhe gjenezën tonë.

Ndërsa popujt e tjerë e sajojnë me lloj-lloj mënyrash 'lashtësinë' e tyre, ne vazhdojmë ta shpërfillim dhe shpërdorojmë antikitetin tonë me indiferentizëm dhe papërgjegjshmëri të frikshme. Në 108 vitet e shtetit modern shqiptar shumë gjera duhej dhe mund të ishin bërë më mirë, por mbi të gjitha duhej të kishim punuar më shumë kryesisht për tu rilidhur me rrënjët tona.

Disa nga mangësitë që vihen re gjatë ekzistencës së shtetit shqiptar shpjegohen me mungesën e një elite kombëtare të përgjegjshme për fatet e vendit.

Faik Konica ka argumentuar se elitën tonë e shkatërruan otomanët. Kjo deri diku është e vërtetë.

Asnjë elitë nuk është e përjetshme. Çdo elitë ka ciklin e saj: ajo lind, lulëzon, venitet, shpërbëhet dhe zëvendësohet me një elitë tjetër me mendësi të re dhe vizion të ri. Ajo që çdo elitë ka të përbashkët është përgjegjësia ndaj fateve të vendit. Mjerë ai vend e popull që mbeten pa një elitë të tillë.

Pushtimi otoman pati kusuret e tij në zhvillimin ose më saktë në stanjacionin tonë kombëtar. Fantazma otomane akoma nuk është larguar nga trojet tona; ajo është rrishfaqur rrishtasi në formën e neo-otomanizmit, metastazat e të cilit po depërtojnë gjithmonë e më thellë në Shqipëri dhe veçanërisht në Maqedoni dhe Kosovë ku, nën trysni të drekte të Ankarasë, janë edituar edhe tekstet e historisë për periudhën e pushtimit turk.

Sindroma e 'faktorizimit' të pafund të faktorit të jashtëm është një tregues tjetër i tendencës tonë kolektive për të mos marrë përsipër fajet tona. Në 100 vitet e fundit vetë ne shqiptarët jemi shkaktarët kryesorë që kemi mbetur pa elitë. Për rrjedhojë, ne jemi bërë pre brezash-ofiqarësh, motivi kryesor i të cilëve është pasurimi nëpërmjet uzurpimit dhe monopolizimit të shtetit.

Dihet se si përfunduan një numër i madh i nënshkruesve të deklaratës së pavarësisë, këtyre



vizionarëve të cilëve u detyrohemi aq shume. Fati i Nolit, Fishtës dhe Konicës dëshmon se sa e vështirë ka qene dhe mbetet për elitën shqiptare të ketë mundësi t'i shërbej vendit. Fakte të reja trishtuese kanë dalë në dritë se si u trajtua elita intelektuale nga Enver Hoxha. Komunizmi ishte një periudhë paradoksale: arsimimi masiv rezultoi në një inteligjencë inerte. Që intelektualët janë zëri më i mekur i shoqërisë shqiptare edhe në 'demokraci' duhet të na shqetësoj dhe tremb të gjithëve.

Një komb pa elitë është një turmë të cilës mund t'i servirësh lehtë idenë se nuk bën dot kurrë pa 'faktorin' e jashtëm. Kjo shpjegon se përse kemi kaq shume 'vëllezër' dhe 'miq' – turq, sllavë, italianë, gjermanë, sovjetikë, kinezë, amerikanë – të cilët i ndërrojmë si veshjet me ndërrimin e stinëve.

Ne na është krijuar bindja se nuk bëjmë dot pa një fuqi të huaj dhe për pasojë nuk përpiqemi të gjejmë forcën mes nesh. Aktualisht, çështjen e korrupsionit endemik qeveritar presim të na e zgjidhin amerikanët dhe BE-ja.

Ky inferioritet patologjik ndaj të huajve, vihet re qartë edhe në diskursin infantil në Shqipëri dhe Kosovë, për 'ëndrrën Europiane'. Kjo nuk përbën ndonjë çudi po të kemi parasysh se personat që negociojnë anëtarësimin e këtyre dy trojeve shqiptare në BE zor se e dinë se, në lashtësi, fillimisht 'Europë' quhej vetëm gadishulli Ilirik.

Ne kemi kohë që jemi katandisur në nxënës të prapambetur që bëjmë detyra shtëpie me imponim që të na pëlqej Europa, por nuk e kuptojmë se reformat duhen bërë pikë së pari se janë të domosdoshme që Shqipëria dhe Kosova të funksionojnë si shtete normale. Ngërçi shtetëror që po përjeton Kosova diktohet edhe nga disa rrethana për të cilat nuk do të ndalem në këtë intervistë.

Situata në të cilën është katandisur shteti shqiptar me kryeministra që sillen dhe veprojnë si kapo dhe me një opozitë qesharake, është e pafalshme. Pra, në përgjigje të pyetjes tuaj, se si e shikoj unë perspektivën e Shqipërisë, mund të them se vetëm me konsolidimin e shtetit ligjor, ku të gjithë të jenë të barabartë para ligjit, vendi ynë do ingranohet me dinjitet në botën demokratike.

Cilat janë krizat që ju mendoni se klasa politike shqiptare duhet t'i tejkalojë në mënyrë që Shqipëria të ketë një model zhvillimi?

Në Shqipëri nuk ka 'klasë politike' por 'kaste kulisash'. 'Rekrutimi' në të, përcaktohet nga shkalla dhe kohëzgjatja e 'besnikërisë' ndaj sekserit që shpërblen 'mercenarët' me kocka nga gostia e pafund në kurriz të pasurive të vendit. Sekserët e kësaj kaste që qeverisin me rotacion nuk dallohen për ndonjë filozofi politike. Ata janë njerëz të rëndomtë, me një arsimim të cunguar që mangësitë e formimit intelektual përpiqen t'i fshehin pas 'titujve shkencorë' që, si çdo gjë në jetë, i kanë të vjedhura.

Këta sekserë janë shkaktarët kryesorë për atë që Emile Durkheim i quan 'anomie' që ka kapërthyer jo vetëm ata por edhe nëpunësit e thjeshtë në çdo segment të shtetit qendror dhe lokal; pra, ata janë robër të obsesionit të pa kontrollueshëm për pasuri pa fund në një botë që nuk njeh asnjë rregull. Këta gjallesa banale kanë legjitimizuar përjetësinë e pushtetit nëpërmjet korrupsionit të votës.

Pa një reformim rrënjësor të sistemit të zgjedhjeve lokale dhe kombëtare, dhe pa një arsim modern në çdo hallkë, nga ai parashkollor e deri në atë pasuniversitar, Shqipëria do të vazhdojë të zbuluroj fasadën pa rikonstruktuar thelbin.

Po kaq i rëndësishme është reformimi i partive politike që, tani për tani, janë shndërruar dhe funksionojnë kryesisht si biznese private.

Në Shqipëri nuk do të ketë zhvillime demokratike po që se nuk funksionon opozita. Në ketë drejtim, Shqipëria është më keq se çdo vend tjetër që doli nga sistemi komunist. Edhe në kohën e monarkisë, në disa momente parlamenti shqiptar funksiononte në mënyrë më efektive.

Dhe së fundi, Shqipëria nuk mund të dalë nga ky ngërç pa angazhimin direkt të elitës së diasporës. Dyert e shtetit shqiptar për intelektualë të pavarur në diasporë, të cilët nuk i bëjnë temenara asnjë partie apo pushtetari por që kanë pasionin për t'i shërbyer vendit me përkushtim, vazhdojnë të jenë të mbyllura në Shqipëri.

Erjon Dervishi

Zanafilla e universit artistik, të mjeshtrit të fjalës artistike, Zeqir Hysa, i ka fillesat në burimet e pashtershme karstike të maleve të Gollobordës

parathënia

POEZI E BURUAR NGA DAMARËT E TOKËS

MIMOZA ÇOBO*


Zanafilla e universit artistik, të mjeshtrit të fjalës artistike, Zeqir Hysa, i ka fillesat në burimet e pashtershme karstike të maleve të Gollobordës, të cilat rrjedhin në thellësitë e muzës gurgulluese të këtij poeti, brenda kodeve normative të ligjërimit të tij letrar, të gjuhës artistike dhe strukturës së tij kompozicionale. Duhet theksuar se ky univers artistik, të jep mundësinë të studiosh shtigjet ku ka shtegtuar pena e poetit për realizimin me sukses të përmbajtjes artistike të veprës, nga pika më e lartë e saj, deri në thellësitë e shtresave, ku shpërthen magma e shpirtit të tij lirik e rebel. Përmasat e forcës së fjalës artistike, që natyrshëm kapërcejnë si dhe oazi me figuracione letrare, që mbartin tonalitetin e veprës, e bëjnë këtë univers poetik, të fitojë bukuritë piktoreske, magjinë e natyrës së virgjër të atyre maleve me histori epike, që poeti Hysa, i kanë shtruar sofrën e lashtësisë, me ujin që rrjedh nga zemra e Koritnikut dhe derdhet në lugun e arave të zallit të Ostrenit të madh, duke sjellë me vete jo vetëm përtëritjen e jetës, por dhe grumbuj idesh fabulistike, të cilat poeti Hysa i përdor, për të formuar një trajtë të re poetike, në formatin e universit të tij artistik."/ Mbi majën e malit Krijoshi, borëngjeshur, /Emrin tënd atdhe, si gollobordas, kam çimentuar"/. Nëse i kushtojmë vëmendje të veçantë këtyre vargjeve, do të ndiejmë jo vetëm peshën e ekzistencës se atyre maleve, por dhe ndjenjën e krenarisë kombëtare, që spikat ndjeshëm, si në këto vargje, por dhe në shumë poezi të këtij vëllimi poetik.

Poeti Hysa ,e sjell vargun poetik si krijim piktorik, imagjativ e plotë fantazi kreative, me tinguj të ngrohtë lirik ,të cilin lexuesi e kupton dhe e ndjen përmes aftësisë së tij përfytyruese, si tek vargjet e poezisë lirike "Lirikë...": "/Kohë dimri. Çdo gjë duket e larë, /me trëndafila bore në parvaz. /Të gjitha andrallat tona dashurore, /I lamë si kujtime në kafaz..."/.

Autori Hysa me individualitetin e tij poetik, dëshmon se është poet me ndjesi të veçanta konceptuale e gjerësi mendimi, në thelb të të cilit qëndron filozofia, që ngjall përfytyrime shumëshqisore të lexuesit, për të zhbërur thellësitë e vargut, në kërkim të perlave shpirtërore, të cilat i mbushin boshllëkun e përditshmërisë, apo të ndiejë dozën e fortë të hidhërimit a trishtimit apokaliptik, si tek poezia "Heshtje": "/Ngrirë heshtja jote, /Si stalagmite prej akulli, /Që një vit s'të shkrinë, /Që po i përcjell, me funeral ditët e trishtita... /Mungesë jete, mërzi akulli. /Fjala, që e ftohur, ilaç kërkon. /Dhe si heshtje prej varri, /qivure kristali, më dërgon..."/. Siç shihet dhe nga raporti që kjo poezi krijon me lexuesin, poeti Hysa është mjeshtër në krijimin dhe vizualitetin e figurës, jo vetëm si nocion abstrakt, por edhe konkret, që gjatë procesit të krijimit, fiton format e saj metaforike dhe cilësi alegorike, duke vënë në lëvizje veprimin dramatik, që përcjellë idenë, se nga heshtja e ftohtë e fjalës, që i ngjan stalagmiteve prej akulli, përgatiten qivure kristali.

Siç e theksova edhe më sipër, poeti Zeqir Hysa, di të përzgjedh me delikatesë materialin fabulistik, por dhe ndjesitë që prekin thelbin së bukurës, që venitet nga klithma kumbuese e urisë dhe e trishtimit të pamatë migjenian. Ja si shprehet Ai, në vargjet e poezisë lirike: "Zogu i uritur": "/Rrëmujë, fjolla të bardha dëbore bien. /Qilimin e natyrës pa kuptuar qëndisin, /I ftohti acar, piklat në kristale, i kthen. /Një zog pushëbardhë në dritare vjen, /çukit xhamin me mirësi, /në këtë kohë acari, më kërkon miqësi. /Nga acari kënga në sqepin e vogël i ngeci..."/.

Si poet i ndjesive të holla poetike, Zeqir Hysa,



arrin të përcjellë me finese brenda vargut jo vetëm ethet e natyrës, por edhe ethet e dashurisë, që shkundin e drithërojnë thellësitë e shpirtit njerëzor, me tone të theksuara dramatike. E gjitha kjo dhembje shprehet artistikisht në mënyrë madhështore, rreth së cilës plekset fati vetjak i heroit lirik, ku ruhen notat e dashurisë së humbur, si tek poezia "Ethe Vjeshte": "/Kam ethe, në këtë ditë vjeshte. /Kam ethe këtu, në bash të shpirtit, /në tik-takun e dashurisë. /Ligështimi pemëve vjeshtore, /në shpirtin tim vizitore"/. Një persiatje, mendimi të hollë, /ku pika loti koha lëngëzon. /Ose, vesë e tejdukshme jete. /Kam ethe, një drithërimë pendese, /për kthimin e freskut, nga vjeshta, që paralajmëron dimër. /Ndjenjë ironie jeta në natyrë. /Shoqëri mes ngjyrash, kur ngjyrat s'kanë, ngjyrë..."/.

Furtuna e ndjesisë së mallit i prish kufijtë kohor në shpirtin e njeriut, i kthehen në një kohë të përjetshme. Rigëtimin e mallit mund të krahasohet me fladin e trimaverës që gjarpëron pa shkak në thellësitë e shpirtit dhe djeg e përvëlon, më shumë se një mijë diej të zjarrit. Dhe pse malli ka detaje të pashpjegueshme sikurse vetë jeta, atmosfera e ndjesive të këtij malli në poezinë "Mall", herë vjen si një pëshpërimë, a ledhatim dashurie e herë si ankth e breg që nuk tret asnjë përbërës natyror, sado i fuqishëm qoftë. Këto ndjesi përforcohen akoma më shumë nga metaforat mbresëlënëse, të ndërtuara brenda një imazhi pothuaj piktorik, duke përcjellë ndijime e emocione të fuqishme tek lexuesi: "/Tek bie nata, /ku kufiri i syrit me qasjen treten, /e fëshfërima dehëse e erës, /lëkurën time gërget. /Ti si një yll që vetëm tretet, ngadalë, /nëpër terrin e natës zbret, /e ankthi im, struket në zemër, /si manari i trembur, që lëshon kopenë..."/.

Duke gjurmuar në thellësi vargjet e poetit Hysa, njohim filozofinë meditative, që kërkon të njohë jo vetëm të fshehtat e natyrës, por edhe të shpirtit njerëzor që lufton për mbijetesë dhe ëndërron për një jetë më të mirë, në një vend ku drejtësia dhe çdo gjë është përmbysur. Me aftësinë e vëzhgimit të mprehtë ndaj fenomeneve negative të kohës, ai shpreh me nota melankolike skepticizmin ndaj realitetit të kohës, rënien morale dhe dekompozimin e shoqërisë. I vetëdijshëm, ngre

zërin deri në zenit për fatet e kombit, por thellë në shpirt e frikëson përgjumja letargjike e një populli të tërë. Apokalipsin e kësaj gjendje tragjike e ka kritikuar e fshikulluar ashpër në poezinë "Bulqizë e kromit vdekjeprurës...": "/Të ikën truri, ky vend minatori, /sa kufoma fatkeqe të burgut mori. /Një grusht me krom, një grusht me dhe, /për bosët pasuri nga shfrytëzimi u bë. /Për afro më shumë se gjysmë shekull, /Kromi më tepër se lufta njerëz ka vdekur. /Këtu toka e nëntoka, pjell çdo pasuri, /krenohet Bulqiza, për krom dhe varfëri... /Pak krom, pak krom, thellësive kërkojnë. /Fëmijët e vegjël, me kova ngarkuar, /Për pak bukë kromi, jetën shkatërruar. /Poema e Migjenit, këtu ka zënë vend, /po njerëzit e varfër, s'kanë zënë mend..."/.

Dramën e madhe njerëzore ,pikëllimin dhe dhimbjen për fatin njerëzor, autori Hysa, e shpreh me thirrjen "Hapu qielli blu "në poezinë "Sikur...", me dëshirën e madhe për të jetuar çastet kimerike që i fal jeta, deri në ditën e prehjes së madhe. I kthjellët, ngushëlluar nga fryma e mjeranëve i lutet qiellit t'a godas me shuplakë, i përgjërohet dëborës së ftohtë t'i puth kurrizin e dorës që t'i lëviz gjaku në damarë dhe shpirti të gurgulloi dashurinë parajsore. Kjo qëndresë stoike për ringjallje, e vënë përballë mjerimit dhe fatit njerëzor, mbart bukurinë dhe madhështinë e artit të këtij mjeshtri të fjalës artistike, që pa asnjë dilemë, të nxit për ekzaminim më të thellë të universit të tij artistik e shpirtëror :"/Hapu qielli blu, /mjaftë, se u lodhe i fshehur, /në gërmadhën e ëndrrës. /Dhe s'jam i vetëm fillikat, /në këtë copë të botës, /se mijëra gjëra më rrethojnë, /si pikël uji në mes të gotës. /Këta njerëz, këto shtëpi, /këta male, kjo kaltërsi, /Ah, ç'kalandi, ç'varfëri, /Le të më pushtojë era e tufani, /kur të më ngushëlloj me frymë mjerani, /le t'më fus shuplakë qielli yjeshumë, /me mua idhnak, në lëvizje e në gjumë. /Vetëm pak hapësirë, në agim të marr, /Me puth në kurriz të dorës, /të më lëvizë gjaku nëpër damarë sikur më ke falur, /dashurinë e parajsës që ditën e parë!..."/. Klithma e poetit është saga tronditëse dhe realiste e varfërisë së tejskajshme që ka shtrirë kthetrat e vdekjes, jo vetëm në viset e Gollobordës, por në të gjithë vendin. Në këto vise nga kanë dalë njerëz të mëdhenj ,si kryeministri turk Mustafa Qemal Ataturku dhe një pafundësi kuadrosh të lartë me tituj e doktoratura, njerëz të thjeshtë punëtorë e gurëdhëndës mjeshtra duarartë, prej të cilëve dikur jehonte shprehja legjendë :"/Po të digjet Stambolli e ndërton Golloborda " , kurse sot, shkërmoq majat e thepisura të maleve shekullor, shprehja tronditëse: "/Nëse digjet Stambolli e ndërtojnë Gollobordasit, po nëse digjet Golloborda, kush do e ndërtojë ?..."/.

Si përfundim mund të shprehem, se universi artistik, i autorit Zeqir Hysa, me strukturë artistike unikalë, ka në thelb parime estetike, që janë elementët bazë të artit të mirëfilltë, përmes të cilave finalizohet artistikisht uniteti dhe filozofia e këtij universi magjiplotë. Gjuha e thjeshtë, stili i rrjedhshëm e lakonik, shprehësia tingullore e figuracioni i pasur letrar, u japin vargjeve lirizëm të theksuar mbresëlënëse, duke bërë që poezia e autorit Hysa, të ketë imazhe sugjestionuese, e të cilësohet poezi moderne.

Kam mendimin se ky vëllim poetik ka forcë për të përcjellë fuqishëm botën shpirtërore dhe filozofinë e poetit për jetën, dashurinë e dhimbjen njerëzore, ka magjinë për të depërtuar thellë në shpirtin dhe neuronet e trurit të lexuesit. Si i tillë, arkitektura e ndërtimit të tij është e larmishme, e denjë për të qenë pjesë e letërsisë së sotme bashkëkohore moderne.

***Poete, kryetare e Shoqatës Letrare-Artistike "Princ Muzaka"**



ENGJËLL MUSAI
Drejtor i gazetës "Telegraf"

Ka kaluar një vit që nga publikimi i pjesë së parë të librit "Oficeret shqiptare në rrjedhën e historisë", i autorëve Suzana Jahollari e Kujtim Boriçi, e tashëm na vjen në duar pjesa e dytë e tij. Si një nga miqtë e kolegët e afërt të autorëve, më vjen mirë të konfirmoj se kjo periudhë, vërtetoi plotësisht atë që unë pohova në hyrje të volumit të parë për lexuesin se : "...Dua të pohoj se ky libër krejt i veçantë në publicistikën historike të 20 viteve të fundit, është para së gjithash një punim serioz publicistik dhe historik i munguar deri tani. Njëpërmyet dokumenteve

"Oficeret shqiptare në rrjedhën e historisë", publicistikë me vlera, dokumentare e historike

të arkivave në kohë të ndryshme, në Shqipëri e jashtë saj, njëpërmyet portreteve, dëshmime e ngjarjeve mbi rolin e grave ushtarake ndër shekuj, në pjesën e parë të këtij libri, silltet një pjesë e historisë së qëndresës së popullit tonë përballë invazioneve, veçanërisht për rolin e pazëvendësueshëm të grave shqiptare...!". Në mos gaboj, për këtë libër (pjesën e parë), gjatë një viti, është shkruar më shumë se për këdo libër tjetër të këtij lloji në gazetën qendrore të kohës, nga studiues e lexues të thjeshtë. Dhe të gjithë, e kanë vlerësuar këtë libër si një arritje në publicistikë dhe si një libër me vlera dokumentare dhe historike për rolin e grave tribune e me uniformë në dekada e shekuj, brenda e jashtë kufijve aktualë të Shqipërisë. Dhe ja, tani vjen pjesa e dytë e tij, në të njëjtën linjë, shton vlera të tjera në këtë kolanë interesante. Njëkohësisht, rikonfirmoj se kam kënaqësinë dhe nderin



të promovoj këtë libër në gazetë për një lexues më të gjerë. Urime dhe

suksese në vazhdim autorëve Suzana Jahollari e Kujtim Boriçi!

PROFILI

Oficerja e re, Klenisa Xheka nga Bulqiza: Uniforma më bëri të përjetoj emocione të veçanta

Quhem Klenisa Xheka, e lindur më 27 prill të vitit 1997, në qytetin e vogël të Bulqizës. Kam mbaruar studimet e larta në degën Shkenca Politike & Marrëdhënie Ndërkombëtare në Tiranë. Duke lënë pas ëndrrën time për gazetarinë, mbylla me rezultate tepër të mira ciklin 3-vjeçar. Që e vogël, kam ndjekur botën e medias, duke nisur me recitime në vitin 2005, duke vijuar me pas si moderatore e lajmeve në konkurse të ndryshme pranë qytetit tim. Në asnjë moment të jetës, nuk e kisha menduar veten pjesëtare të uniformës.

E në fakt, mbaj mend para se daja im të ndërronte jetë si një oficer i denjë e i përkushtuar, pas punës, uniformës i kushton-te rëndësi të veçantë, pasi për të, uniforma ishte detaji që e bënte një ushtarak të ishte vigjilent. Pavarësisht këtij detaji, pyetjet e mia i kisha gjithmonë të kursyera rreth uniformës, pasi mendoja që privatësia ushtarake, nuk duhej cenuar. Nuk e di si ndodhi, por diçka brenda vetes, më thoshte që unë duhej te aplikoj në atë kurs. Ne fakt, ashtu ndodhi. Konkurrova, u përzgjodha dhe fjalët motivuese të familjarëve të mi, ishin shtysa e vetme që më bënë mua të besoj që gjithçka që e dëshirojmë fort, e arrijmë. Ishin këto fjalët që mora me



vete, pikërisht në datën 15 tetor 2018, ku jeta ime mori një rrjedhë krejtësisht tjetër. Nisi kursi 9-mujor, ku 3-mujat e parë, u zhvilluan

në Bunavi të Vlorës me instruktorë e oficerë përkatës. Ishte një nisme krejt e panjohur për mua, e vështirë, por që në vetvete mbarte

një lloj bukurie të veçante. Brenda vetes, me thoshte diçka që këtë nismë, duhet ta duash e pastaj ta arrish. Ndihesha ndryshe nga të gjithë pjesëtarët e shoqërisë, të qenurit pjesë e uniformës, bënte diferencën për mua. Më pas, në janar të vitit 2019, kursi nisi në Zall-Herr, për gati 6-muj. Ishin ditët e një rutine të njëjtë, derisa pak nga pak, ditët po pasonin kohën njëra-tjetrës, me padurim, prisja ditën e diplomimit. 19 korriku, ishte dita që më bëri të përjetoj emocionet unike të të mbajturit mbi supe gradën time të parë, ndjesinë e të qenurit pjesë e familjes së madhe të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Pas përfundimit me sukses të kursit 9-mujor me datë 01.08.2019, mora emërimin e parë pranë batalionit të dytë të këmbësorisë (B2K), në një kompani mbështetëse logjistike, me detyrë komandante e togës së mbështetjes. Disa javë më pas, ndoqa kursin bazë të oficerit me specializim logjistikën, në degën furnizim. Dalëngadalë, tashmë unë isha bërë pjesë e familjes së madhe të Forcave të Armatosura, shërbej për atdheun tim. Uniforma më bëri të përjetoj emocione të veçanta unike, duke më dhënë vlera, nder dhe krenari, si një oficer e denjë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Qarku i Dibrës ka tashmë katër ekipe futbollit, Burreli e Korabi në Kategorinë e Parë, Klosi në të Dytën dhe Bulqiza në Kategorinë e Tretë.

KATEGORIA E TRETË



Nisje e mirë e ekipit të futbollit "Bulqiza"

Ekipi i futbollit të Bulqizës, një ekip i iri modest, por rezultativ, e zhvillon veprimtarinë e tij futbollistike në kategorinë e tretë, me objektivat dhe symimin që të zerë vendin e parë dhe për të kaluar sezonin tjetër në kategorinë e dytë.

Ndeshjet e kesaj kategorie zhvillohen në kompleksin e fushave në Kamez në Tiranë. Të dy ndeshjet e para të këtij kampionati ekipi ynë me administrator Andi Topin, me drejtor teknik dhe trainer Hakik Çekici dhe zëvendës trainer Flogert Rrushi, i ka fituar si vijojn:

Bulqiza - Osumi 6-0 dhe Bulqiza - Kinostudio 2-1.

Në këtë kategori marrin pjesë 8 ekipe.

Në ndeshjen e dytë, ajo mes ekipit Bulqiza dhe ekipit të Kinostudios pati rivalitet. Djemtë e ekipit të Bulqizës u treguan më të kujdesshëm dhe sulmuan më shumë në portën kundërshtare. Në minutën e 11-të kaluan në avantazh me anën e sulmuesit Andri Cara.

Me këtë rezultat u mbyllën 45 minutat e pjesës së parë.

Me fillimin e pjesës së dytë ekipi ynë nuk e lëshoi lojën dhe si rezultat do të shënohej

edhe goli i dytë për ekipin tonë po nga sulmuesi Cara, i cili shënon një dy golësh në këtë ndeshje.

Në mesin e pjesës së dytë ekipi i Kinostudios shkurton rezultat duke e çuar atë në 2-1 për Bulqizën.

Në minutat e mbetura ekipi ynë sulmoi përsëri por pa shënuar duke e fituar takimin me rezultat përfundimtar 2 - 1 dhe duke kryesuar kampionatin me pikë të plota.

Po ashtu para disa ditësh, në kompleksin sportiv "Loro Boriçi" në Kamëz, është zhvilluar ndeshja mes ekipit të Bulqizës dhe atij të Urës Vajgurore, KF Osumi. Skuadrën e ka mbështetur edhe kryetari i Bashkisë Bulqizë, Lefter Alla, i cili më herët pati deklaruar se ishte angazhuar përzemësisht në ringritjen e këtij ekipi pas një mungese prej 6 vitesh.

Sipas të dhënave të marra nga drejtuesit e ekipit mbështetës në financim është 100% Bashkia Bulqizë.

Qarku i Dibrës ka tashmë katër ekipe futbollit, Burreli e Korabi në Kategorinë e Parë, Klosi në të Dytën dhe Bulqiza në Kategorinë e Tretë.



RETE PAS

Shërbime shëndetësore me cilësi të lartë dhe çmime të përballueshme

Një program i rezervuar dhe personalizuar për qytetarët shqiptarë për të hyrë në shërbime shëndetësore me cilësi të lartë dhe çmime të përballueshme.



FIRENZE RETE PAS, GARANTON: Shërbime shëndetësore në të gjitha disiplinat e specializuara diagnostikuese dhe rehabilituese; Një rrjet ambulatorial i përbërë nga 11 qendra në territorin e Firences dhe me një mesatare prej 20,000 hyrje në muaj.

Shërbim i shpejtë pa kohëpritje.

Komunikimi mundsohet nga përkthyes të specializuar në këtë fushë

NDËR SPECIALITETET QË NE OFROJMË JANË

- Alergologjia, Angiologji, Kardiologji, Kirurgji, Dietologji, Dermatologji, Ecografi, Endokrinologji, Gastroenterologji, Gjinekologji, Gjeriatri, Neurologji, Nefrologji, Okulistika, Ortopedia, Osteopatia, Otorinolaringologji, Pediatria, Pneumologji, Psikiatri

RETE PAS ofron shërbime shëndetësore me tarifa të përballueshme për të gjithë, me një ekip mjekësh italianë me aftësi të larta, veçanërisht në fushën e diagnostikimit:

- radiologji,

- resonance magnetike, tac -

Mamografi dhe tomosintezë, -

ekografi ... me përdorimin e pajisjeve të avancuar për rindërtimin e imazheve volumetrike, në tredimensione (siç është për tomosintezën e gjirit).

ORGANIZOJME GJITHCKA në kohën që ju ose i afërm juaj do asistohen/ni në strukturat tona. • Shoqërimi në çdo vizitë e pacientit me përkthyes shqiptar.

Per informacione dhe prenotime na \kontaktoni:

Email: age.biba@gmail.com

Tel 00392380019580

WhatsApp 00392380019580

Age Biba (Dukagjini)

Organizojmë gjithçka në kohën që ju ose i afërm juaj do asistohen/ni në strukturat tona. • Shoqërimi në çdo vizitë e pacientit me përkthyes shqiptar.

Për informacione dhe prenotime na kontaktoni: Email age.biba@gmail.com
Tel 00392380019580 WhatsApp
00392380019580
Age Biba (Dukagjini)